



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 20.10.2020, Nr.157/2020, për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, dhe vendimin e Presidentit të datës 20.10.2020, Nr.158/2020, për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, Rregulloren Nr. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm në SKQZ, si dhe nenin 23, nenin 10 dhe nenin 58 të Ligjit nr. 1.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbajtur me datë 21.10.2020 nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Planit të Buxhetit për Kompensimin e Orëve Shtesë Jashtë Orarit të Rregullt të Punës për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) miraton propozimin e Sekretariatit të KQZ-së për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut, të cilat do të mbahen më 29.10.2020,
 - a. Për anëtarët e KQZ-së, deri në 40 orë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës;
 - b. Për zyrtarët të Sekretariatit të KQZ-së, deri në 40 orë punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës;
 - c. Zyrtarin e Lartë Komunal të Zgjedhjeve në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut, deri në 40 orë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës;
- II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe zbatohet prej datës së shpalljes së zgjedhjeve, nga data 21.10.2020.

Prishtinë, 21.10.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka

